

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 551(2) - aktgjykimi i formës së prerë pas hyrjes në fuqi të KPPPK-së -135(2) LPK - vjedhja e rëndë - kërkesa e hudhur poshtë - neni 451, 454(2) KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale dhe të Qarkut të Pejës për shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale kur shkelja e tillë ndikon në ligjshmërinë e aktvendimit të Gjykatës, siç parashihet me nenin 451 (1) pika 1 dhe nenin 451 (3) të KPPPK-së.

I pandehuri është akuzuar për veprë penale të vjedhjes së rëndë, është shpallur fajtor, dhe është dënuar me dënim prej gjashtë muaj burgim.

Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa është paraqitur para hyrjes në fuqi të kodit të ri dhe aktgjykimi në këtë çështje ka marrë formë të prerë para hyrjes në fuqi të KPPPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e papranueshme.

Pkl.nr.10/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarët: Miftar Jasiqi dhe Zait Xhemajli, anëtarë, në bashkëpunëtorin profesional Suad Kuraja, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të gjykuarve I. L. nga fshati Tërboviq, komuna e Pejës dhe A. K. nga fshati Shtupeq i Vogël, komuna e Pejës, për veprën penale vjedhje e rëndë të parashikuar nga neni 135 par.2 të LPK, ndërsa i gjykuari I. L. edhe për veprat penale vjedhje e rëndë të parashikuar nga neni 135 par.1 të LPK, përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të të gjykuarit A. K. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Pejë, P.nr.384/2001 datë 26.12.2002 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ap.nr.23/2003 datë 17.03.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.06.2004, mori këtë

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë si e papranueshme kërkesa e mbrojtësit të të gjykuarit A. K. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Pejë, P.nr.384/2001 datë 26.12.2002 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ap.nr.23/2003 datë 17.03.2004.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale Pejë, me aktgjykimin P.nr.384/2001 datë 26.12.2002, të akuzuarin A. K. e ka shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë të parashikuar nga neni 135 par.2 të LPK dhe e ka gjykuar me 6 (gjashtë) muaj burgim. Gjykata e Qarkut Pejë, me aktgjykimin Ap.nr.23/2003 datë 17.03.2004, përkitazi me të akuzuarin A. K., ka refuzuar ankesën e tij dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. K., av. Osman Lajçi nga Peja, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procesurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, parashikuar nga neni 451 par.1 pika 1 dhe 3 të KPPPK, me propozim që kjo Gjykatë kërkesën në fjalë ta pranojë dhe aktgjykimet e kundërshtuara t'i prishë, kurse çështjen t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPPK dhe gjeti se:

Kërkesa është e papranueshme.

Me dispozitën e nenit 551 par.2 të KPPPK është parashikuar se i dënuari dhe mbrojtësi i tij mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë vetëm për ato aktgjykime që marrin formë të prerë pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi. Në rastin konkret aktgjykimi ka marrë formën e prerë me datën 17.03.2004, kurse Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës ka hyrë në fuqi më 06.04.2004.

Me dispozitën e nenit 454 par.2 të KPPPK është parashikuar që Gjykata Supreme e Kosovës e hedhë poshtë me aktvendim kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse kërkesa është e papranueshme.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, duke marrë parasysh se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, kjo Gjykatë çmon se kërkesa në fjalë është e papranueshme, siç parashikon dispozita e nenit 551 par.2 të KPPPK, prandaj në kuptim të nenit 454 par.2 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pkl.nr.10/2004, datë 04.06.2004

Procesmbajtësi,
Suad Kuraja

Kryetari i Gjykatës-kolegjit
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 2(2) KPPK - kualifikimi juridik i veprës - aplikimi i ligjit më të favorshëm - neni 157(3)(1) LPK, neni 19 LPJ - shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm - aktgjykimi i ndryshuar - neni 291(3)(1) KPPK, 454(1), 457(1) pika 1 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjytimeve të Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës për shkelje të nenit 451 (1) të KPPK-së, duke bërë pretendimin ankimor se të dyja gjykatat kanë bërë gabim në përcaktimin e cilësimit juridik të veprës penale.

I pandehuri është akuzuar për veprë penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm në bazë të nenit 157(3) në lidhje me nenin 157(1) të LPK-së dhe nenin 19 të LPJ-së, është shpallur fajtor dhe është dënuar me gjashtë muaj burgim.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktgjykimi është marrë pas nxjerrjes së KPPK. Gjykata Supreme ka vendosur se aktgjykimet ishin në kundërshtim me nenin 2(2) të kodit të ri, i cili parashikon se në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur kërkesën e avokatit mbrojtës si të bazuar dhe ndryshoi aktgjykimin në atë të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm në bazë të Nenit 291(3) në lidhje me Nenin 291(1) të KPPK, i cili parashikon një dënim më të butë dhe më të favorshëm se ai me të cilin i akuzuari është dënuar fillimisht.

Pkl.nr.11/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- Kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarët: Shahdane Agani dhe Meleqe Behxheti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mr.Sc. Flora Balidemaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit D. S. nga fshati Nashec, komuna e Prizrenit, për veprën penale shkaktimi i rrezikimit të përgjithshëm, të parashikuar me nenin 157 par.3 lidhur me par.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të gjykuarit av. Zef Delhysa, ngritur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren P.nr.15/2002 datë 17.12.2003 dhe aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.53/2004 datë 13.04.2004, në seancën e Kolegjit të mbajtur më 10.12.2004, me pjesëmarrjen e Prokurorit Publik të Kosovës Ilmi Zhitia, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të gjykuarit D. S., dhe ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr.15/2002 datë 17.12.2003 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.53/2004 datë 13.04.2004, vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale shkaktimi i rrezikimit të përgjithshëm, të parashikuar me nenin 157 par.3 lidhur me par.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se në veprimet e të gjykuarit qëndrojnë elementet e

veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, të parashikuar me nenin 291 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prizren, me aktgjykimin P.nr.15/2002 datë 17.12.2003, të akuzuarin D. S., e ka shpallur fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikimit të përgjithshëm të parashikuar me nenin 157 par.3 lidhur me par.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi me 6 (gjashtë) muaj. Duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut Prizren dhe asaj të mbrojtësit të të akuzuarit, Gjykata Supreme, me aktgjykimin Ap.nr.53/2004 datë 13.04.2004, i ka refuzuar ato si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër aktgjytimeve të lartpërmendura mbrojtësi i të akuzuarit, av. Zef Delhysaj ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të parashikuara me nenin 451 par.1 pika 1 të KPPK-së, në dëm të të gjykuarit, duke theksuar se Kodi i Ri Penal, i cili ka hyrë në fuqi më 06.04.2004, për veprën penale shkaktimi i rrezikimit të përgjithshëm, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, parashihet dënim më i butë se sa ai që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe nga i cili i akuzuari është dënuar. Ka propozuar që kjo Gjykatë ta pranojë kërkesën në fjalë, ashtu që të ndryshojë vendimin e formës së prerë dhe të gjykuarit të shqiptohet një dënim më i butë, apo që në përputhje me dispozitat e nenit 2 të KPPK-së, të zbatohet ligji më i favorshëm për të gjykuarin, apo që të anulohet vendimin e Gjykatës më të lartë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Në seancën e kolegjit ishte present edhe Prokurori Publik i Kosovës, i cili në tërësi qëndroi praën propozimit të bërë në përgjigjen ndaj kërkesës së mbrojtësit për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të kërkesës në fjalë, në kuptim të nenit 454 par.1 dhe nenit 457 par.1 pika 1 të KPPK-së, konstatoi:

Kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton, se Gjykata e Qarkut Prizren, të akuzuarin D. S., me datën 17.12.2003 e ka shpallur fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikimit të përgjithshëm të parashikuar me nenin 157 par.3 lidhur me par.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi me 6 (gjashtë) muaj.

Gjykata Supreme, duke vendosur përkitazi me ankesat e paraqitura kundër këtij aktgjykimi, me aktgjykimin Ap.nr.53/2004, datë 13.04.2004, ka

refuzuar ankesat dhe ka vërtetuar aktgjykimin e kundërshtuar.

Me datën 06.04.2004, ka hyrë në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe në dispozitat e përgjithshme të tij, konkretisht me nenin 2 është parashikuar edhe parimi i zbatimit të ligjit më të favorshëm. Kështu në nenin 2 par.2 të këtij Kodi, shprehimisht është paraparë se “në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.”

Meqenëse, seance e Gjykatës Supreme është mbajtur më 13.04.2004, respektivisht (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm Penal, rrjedh se kolegji i kësaj Gjykate, kur ka vendosur për këtë çështje penale, është dashur ta zbatojë nenin 2 par.2 të KPPK-së, mbi zbatimin e ligjit më të favorshëm, sepse për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, ky Kodi i Përkohshëm Penal parasheh dënim prej 6 muaj deri në 5 vjet, çka do të thotë se në rastin konkret ky ligj është më i favorshëm në krahasim me Ligjin Penal të mëparshëm i cili për të njëjtën vepër ka paraparë dënim prej 1 deri në 8 vjet.

Për këto arsye, është i drejtë pretendimi i mbrojtësit të të akzuarit se, me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të të gjykuarit D. S., nga neni 451 par.1 i KPPK-së, për shkak të moszbatimit të rrezikimit të përgjithshëm të parashikuar me nenin 291 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, parashihet dënim më i butë.

Prandaj, për këtë arsye Gjykata Supreme e pranoi sit ë bazuar kërkesën e mbrojtësit të të gjykuarit dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë nga ky aspekt, duke konstatuar se në veprimet e të gjykuarit të përmendur qëndrojnë elementet e veprës penale të shkaktimit të rrezikimit të përgjithshëm të parashikuar me nenin 291 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Sa i përket propozimit të mbrojtësit për shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj të gjykuarit, Gjykata Supreme çmon se ky propozim është i pabazuar, pavarësisht nga ndryshimi i cilësimit juridik të veprës, sidomos kur merret parasysh fakti se këtij të gjykuari i është shqiptuar një dënim burgimi me 6 (gjashtë) muaj, i cili në realitet paraqet dënimin minimal të paraparë për këtë vepër penale.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 454 par.1 dhe nenit 457 par.1 pika 1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pkl.nr.11/2004, datë 10.12.2004

Procsmbajtëse,
Flora Balidemaj

Kryetari i Gjykatës-kolegjit,
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 403(1) pika 12 KPPPK-së - deklarimi i bazave që kanë të bëjnë me provat materiale - neni 410(4) KPPPK - palët e thirrura me kohë në seancën e apelit - neni 171(4), 165 LPK - vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik- aktgjykimi i ndryshuar - neni 396(7), 451, 457 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale të Kamenicës dhe Gjykatës së Qarkut të Gjilan për shkelje të nenit 403 (1) pika 12 dhe 410(4) të KPPPK-së. I pandehuri është akuzuar për vepra penale të rënda kundër sigurisë së trafikut publik siç parashihet me nenin 171 (4) në lidhje me nenin 165 (3) në lidhje me nenin 165(1) të LPK-së, është shpallur fajtor, dhe është dënuar me kusht.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me procedurën penale, nenin 403(1) pika 12 e KPPPK-së për shkak se ka dështuar të sqarojë faktet vendimtare të veprës penale, kryesisht llojin dhe natyrën e veprës penale të vozitjes të kryer nga i akuzuari. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në kundërshtim me nenin 410(4) të KPPPK-së për shkak se ka dështuar që të njoftojë avokatin mbrojtës për seancën dhe për shkak se ka zhvilluar seancën në mungesë të tyre. Së këndejmi, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e bazuar dhe prishi aktgjykimet dhe ktheu lëndën Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim

Pkl.nr.12/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarët: Shahdane Agani dhe Riza Loci, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit G. G. nga Bujanovci, për veprën penale vepra të rënda kundër sigurisë së komunikacionit, të parashikuar nga neni 171 par.4 lidhur me nenin 165 par.3 lidhur me par.1 të LPK, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të gjykuarit, avokat Vahid Halili, ngritur kundër aktgjykimet të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.97/2001 datë 06.02.2004, dhe aktgjykimet të Gjykatës së Qarkut Gjilan, Ap.nr.56/2004 datë 22.04.2004, në seancën e Kolegjit të mbajtur më 09.11.2004, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si e bazuar kërkesa e mbrojtësit të të akuzuarit G. G. për mbrojtje të ligjshmërisë dhe prishen aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.97/2001 datë 06.02.2004, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Gjilan, Ap.nr.56/2004 datë 22.04.2004, kurse çështja i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Kamenicë, me aktgjykimin P.nr.97/2001 datë 06.02.2004, të akuzuarin G. G. e ka shpallur fajtor për veprën penale vepra të rënda kundër sigurisë së komunikacionit, të parashikuar nga neni 171 par.4 lidhur me nenin 165 par.3 lidhur me par.1 të LPK, dhe e ka gjykuar me kusht, duke i caktuar dënimin me 5 (pesë) muaj burgim, i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, nuk kryen vepër të re penale.

Gjykata e Qarkut në Gjilan, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Publike Komunale të Gjilanit dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, me aktgjykimin Ap.nr.56/2004 datë 22.04.2004, pranoi ankesën e Prokurorit Publik Komunal dhe e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket vendimit për dënimin, ashtu që të akuzuarin, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e gjykoj me 4 (katër) muaj burgim, ndërsa ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit e refuzoi sit ë pabazë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Vahid Halili, ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 403 ar.1 nënpar.12 dhe par.2 nënpar.2 të KPPPK.

Mbrojtësi i të akuzuarit konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 403 par.1 nënpar.12 të KPPPK, e cila qëndron në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë dhe i pakuptueshëm, sepse nga përshkrimi faktik nuk mund të kuptohet se çfarë lëshimi në komunikacion ka bërë i akuzuari, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar nuk shpjegohet fare se çka nënkupton Gjykata me shprehjen “shpejtësi tejmase”, domethënë cila është kjo shpejtësi, për më tepër kur vetë Gjykata konstaton se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur për shkak të lëshimeve të të dëmtuarit S. D., ndërsa pas këtij konstatimi e shpall fajtor të akuzuarin, gjë që aktgjykimin e kundërshtuar e bën të paqartë dhe të pakuptueshëm dhe njëherësh edhe të kundërligjshëm.

Ndërkaq, përse i përket aktgjykimit të shakllës së dytë, mbrojtja pretendon se ai është përfshirë më shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 403 par.2 nënpar.2, e cila ka të bëjë me shkeljen e së

drejtës së mbrojtjes, sepse Gjykata e Shkallës së dytë ka pamundësuar pjesëmarrjen e mbrojtjes dhe të akuzuarit në seancën publike të datës 22.04.2004, duke konstatuar se fletëkthesa për të akuzuarin nuk është kthyer në Gjykatë, ndërsa për mbrojtësin është kthyer pa dorëzim.

Kështu, mbrojtja konsideron se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkeljet e dispozitave ligjore të cekura më lart, prandaj ka propozuar që kërkesa në fjalë të pranohet dhe aktgjykimet e kundërshtuara të prishen, kurse çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Prokurori Publik i Kosovës, me përgjigjen ndaj kërkesës PPK.nr.27/2004 datë 01.07.2004, propozoi që kërkesa e mbrojtësit të të akuzuarit të pranohet si e bazuar.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmoi thëniet e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, përkitazi me ngjarjen e kundërligjshme të automobilin nga ana e të akuzuarit thuhet se i akuzuari ka ngarë atë “me shpejtësi tejmase”, thënie kjo që është e pakuptueshme, sepse nga ky përshkrim faktik nuk mund të kuptohet se a është fjala për tejkalimin e shpejtësisë së lejuar të ngjarjes së automjetit apo për mospërshtatje të shpejtësisë me kushtet e komunikacionit.

Ndërkaq, neni 165 par.1 i LPK, parashikon: “Pjesëmarrësi në komunikacion në rrugë që nuk u përmbahet dispozitave të komunikacionit dhe me këtë rrezikon komunikacionin aq sa vë në rrezik jetën ose trupin e njerëzve ose pasurinë në vëllim të madh dhe për këtë shkak të personi tjetër shkaktohet plagosja e lehtë ose dëmi mbi pasurinë mbi dhjetë mijë dinarë”. Nëse është fjala për tejkalim të shpejtësisë, është dashur që në dispozitiv të ceket fakti se çfarë shpejtësie e lëvizjes është e lejuar në vendin e ngjarjes, (cila ka qenë dispozita e komunikacionit në rastin konkret) dhe me çfarë shpejtësie ka ngarë veturën i gjykuari para momentin të ndërmarrjes së frenimit të saj. Në dispozitiv mungojnë këto të dhëna, të cilat dispozitivin e aktgjykimin e bëjnë të pakuptueshëm. Nëse është fjala për mospërshtatje të shpejtësisë së automjetit, është dashur që në dispozitiv të konkretizohen kushtet e komunikacionit dhe cila shpejtësi e lëvizjes konsiderohet e papërshtatshme me kushtet e komunikacionit, në të cilat është shkaktuar aksidenti. Këto fakte nuk janë përmendur në dispozitiv në dispozitiv, i është i pakuptueshëm edhe për këto arsye. Paqartësitë e cekura më lart kanë të bëjnë me ngjarjen e kundërligjshme të automobilin nga ana e të gjykuarit, fakt ky i rëndësishëm, vendimtar, vendimtar dhe element konstituiv i kësaj vepre penale.

Në pjesën e arsytimit ku flitet për gjendjen faktike, e cila dallon nga gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të të njëjtit aktgjykim, nuk janë cekur në mënyrë të plotë faktet e vërtetuara gjatë seancës kryesore, nuk janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen si të vërtetuara apo të pavërtetuara. Pra, në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk janë dhënë arsyet lidhur me faktet vendimtare, siç parashikohet me nenin 396 par.7 të KPPPK. Këto lëshime përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPPK, siç thuhet me të drejtë në kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarit.

Nga shkresat e lëndës, konkretisht nga aktgjykim i Gjykatës së Shkallës së Dytë rezulton se “në seancën e kolegjit avokati dhe klienti i tij nuk kanë marrë pjesë, ngase për avokatin ftesa është kthyer e padorëzuar, ndërsa për të akuzuarin, fletëkthesa nuk është kthyer në Gjykatë”. Nga kjo del se Gjykata e Shkallës së Dytë seancën e kolegjit e ka mbajtur pa praninë e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, përkundër faktit se në ankesë kanë propozuar që të njoftohen për seancën e kolegjit. Dispozita e nenit 410 par.4 të KPPPK, parashikon se Gjykata e Shkallës së Dytë ka të drejtë të mbajë seancën e kolegjit pa praninë e palëve që kanë kërkuar që të marrin pjesë në seancë, vetëm në rastet kur palët njoftohen për seancën e rregullt. Prandaj, Gjykata e Shkallës së Dytë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 410 par.4 të KPPPK, në aktgjykimin e shkallës së dytë ka shkelur të drejtën e mbrojtjes, të parashikuar nga neni 403 par.2 pika 2 të KPPPK.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, kjo Gjykatë çmon se me aktgjykimet e kundërshtuara janë bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 403 par.1 pika 12 dhe neni 403 par.2 pika 2 lidhur me nenin 451 par.1 pika 2 dhe 3 të KPPPK, sepse këto shkelje kanë cenuar ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e aktgjyimeve, për të cilën arsye u pranua si e bazuar kërkesa e mbrojtësit të të akuzuarit dhe u prishën aktgjykimet e kundërshtuara, për t’iu kthyer lënda për rigjykim Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjatë riprocedimit, Gjykata e Shkallës së Parë duhet t’i mënjanojë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të sipërmenduara, të caktojë dhe të mbajë seancën kryesore dhe, në fund, të marrë një vendim të drejtë e të ligjshëm në këto çështje penale.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 457 par.1 par.2 të KPPPK, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pkl.nr.12.2004, datë 09.11.2004

Procesmbajtësi,

Kryetari i Gjykatës-kolegjit,

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 403 - shkelja e përgjithshme e procedurës penale - neni 135(1) pika 2 LPK - vjedhje e rëndë - neni 154(1) LPK - fshehje kërkesa e hedhur poshtë - neni 454, 456 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjyimeve të Gjykatës Komunale të Vitisë dhe Gjykatës së Qarkut të Gjilanit për shkelje të nenit 403 të KPPPK-së.

Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është mjet juridik i jashtëzakonshëm, i parashikuar në bazë të nenit 451 të KPPPK-së. Gjykata Supreme gjeti se kërkesa nuk specifikon se cila dispozitë e nenit 403 të KPPPK është shkelur, dhe dështoi të kundërshtoi aktgjykimin në baza ligjore, mirëpo në vend të kësaj është paraqitur ankesa kundër tij në shkallë të dytë, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.

Pkl.nr.13/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarët Avdi Dinaj dhe mr.sc.Fejzullah Hasani anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale mr.sc.Flora Balidemaj procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit N. M. nga fshati Begunc, komuna e Vitisë, për veprën penale vjedhje e rëndë e parashikuar me nenin 135 par.1 pika 2 të LPK-së, duke vendosur përkritazi me kërkesën e të gjykuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës Komunale Viti P.nr.52/2003, datë 27.05.2003 dhe aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut Gjilan Ap.nr.19/2004, datë 11.03.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.03.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të gjykuarit N. M. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës Komunale Viti P.nr.52/2003, datë 27.05.2003 dhe aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut Gjilan Ap.nr.19/2004, datë 11.03.2004.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale Viti, me aktgjykimin P.nr.52/2003 datë 27.05.2003, të akuzuarin N. M. e ka shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë e parashikuar me nenin 135 par.1 pika 2 të LPK-së, dhe veprës penale të fshehjes së parashikuar me nenin 154 par.1 të LPK-së, dhe e ka gjykuar me dënim unik me 8 (tetë) muaj burgim. Duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të

akuzuarit, Gjykata e Qarkut Gjilan, me aktgjykimin Ap.nr.19/2004, datë 11.03.2004, e ka refuzuar ankesën dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjytimeve i gjykuari N. M. ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 403 të KPPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të prishë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rigjykim, apo që ato të ndryshohen.

Prokurori Publik i Kosovës, me parashtresën PPK nr.34/04, datë 07.09.2004, ka propozuar që kërkesa e të gjykuarit për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPPK-së, studimit të aktgjytimeve dhe vlerësimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesën e vet, i gjykuari, në mënyrë të përgjithësuar ka theksuar se janë bërë shkeljet e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 403 par.1, duke mos e precizuar se cilat pika të këtij neni janë shkelur konkretisht. Thekson se, Gjykata e Shkallës së Parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me arsyetim se nuk janë dëgjuar dëshmitarët N. Q. dhe B. B. dhe se aktgjykimet e kundërshtuara janë bazuar në dëshminë e të bashkëakuzuarit P. F., të të miturit M. I. dhe I. Q., të cilat sipas të gjykuarit janë të papranueshme dhe shton se shqyrtimi kryesor është mbajtur pa pjesëmarrjen e personave të ftuar, duke menduar në dëshmitarin N. Q., i cili ka qenë dëshmitar okular. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme këto pretendime nuk janë të bazuara për këto arsye:

Me dispozitën e nenit 451 të KPPPK-së, shprehimisht parashihihen rastet e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik, ndër të cilat janë: shkelje e ligjit penal; shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 403 par.1, shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Duke pasur parasysh se në kërkesën e tij i gjykuari nuk e kundërshton aktgjykimin për baza ligjore për mbrojtje të ligjshmërisë, por vetëm i përgjithëson disa rrethana që për nga përmbajtja, më tepër i ngjajnë ankesës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, që ka qenë objekt shqyrtimi në shkallë të dytë, se sa kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që në rastin konkret është objekt shqyrtimi.

Bazuar në këtë gjendje, Gjykata Supreme vlerësoi se nuk ka kushte ligjore për pranimin e saj, prandaj në përputhje me dispozitën e nenit 456 të KPPPK-së, vendosi sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pkl.nr.13/2004, datë 07.03.2005

Procesmbajtëse,
Mr.Sc.Flora Balidemaj

Kryetari i Gjykatës-kolegjit,
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 403(1) pika 12 KPPPK - deklarimi i bazave që kanë të bëjnë me provat materiale - neni 451(1) pika 1,2,3 KPPPK - bazat për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 115(1) LPK - mashtrimi i blerësve - neni 195(1) - veprat penale të arbitraritetit - kërkesa e refuzuar - neni 454, 455, 456 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë dhe Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës për shkelje të nenit 403(1) pika 12 dhe nenin 451(1) të KPPPK-së. Gjykata Supreme ka vendosur se në bazë të nenit 451(2) të KPPPK-së, një kërkesë e tillë, nuk mund të paraqitet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për shkak se është paraqitur nga i akuzuari në këtë rast. Krahas kësaj, Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatat e shkallës më të ulët kanë vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë faktet vendimtare gjatë marrjes së aktgjyqimeve të tyre, siç parashihet me nenin 387 dhe 396(7) të KPPPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e pabazuar.

Pkl.nr.15/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarër: Shahdane Agani dhe Riza Loci, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit A. H. nga fshati Bajskë, për shkak të veprave penale: mashtrim i blerësve nga neni 115 par.1 të LPK, dhe dy veprave penale vetëgjyqësia nga neni 195 par.1 të LPK, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të gjykuarit, avokat Vahid Halili, ngritur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Vushtri, P.nr.80/2001 datë 01.11.2001, dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ap.nr.196/2001 datë 13.04.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.11.2004, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të të akuzuarit A. H. për mbrojtje të ligjshmërisë, ngritur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Vushtri, P.nr.80/2001 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së

Qarkut në Mitrovicë, Ap.nr.196/2001 datë 13.04.2004.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Vushtri, me aktgjykimin P.nr.80/2001 datë 01.11.2001, të akuzuarit A. H. e ka shpallur fajtor, për shkak të veprave penale: mashtrim i blerësve nga neni 115 par.1 të LPK, dhe dy veprave penale vetëgjyqësia nga neni 195 par.1 të LPK, dhe e ka gjykuar, pasi për secilën vepër i caktoi dënimet me burg veç e veç dhe këto: për veprën penale në pikën I të dispozitivit-me 6 (gjashtë) muaj, për veprën penale në pikën II të dispozitivit-me 1 (një) muaj, dhe për veprën penale në pikën III të dispozitivit-me 1 (një) muaj, e ka gjykuar me dënim unik burgu prej 7 (shtatë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 27.04.2001 gjer më 01.06.2001.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarit, me aktgjykimin Ap.nr.196/2001 datë 13.04.2004, e kryesisht e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me: veprat penale të përshkuara nën pikën II dhe III të dispozitivit, e refuzon akuzën conform nenit 349 pika 6 lidhur me nenin 365 pika 3 të LPP, ndërsa për veprën penale të përshkuara nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar përmbushen të gjitha elementet e veprës penale mashtrimi i blerësve të parashikuara në nenin 242 par.1 të KPPK, për të cilën vepër e gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 27.04.2001 deri më 10.06.2001.

Kundër këtyre aktgjyqimeve, mbrojtësi i të akuzuarit avokati Xhafer Maliqi, ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal.

Në kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarit thuhet se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, në pjesën gjyquese dhe ai i Gjykatës Komunale në Vushtri, përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara nga neni 403 par.1 nënpar.12 dhe par.2 të KPPPK. Lidhur me këto shkelje, mbrojtësi në fakt bën fjalë për gjendjen faktike. Kështu, në kërkesë theksohet se lidhur me këtë çështje penalo-juridike Gjykata Komunale në Vushtri ka bërë tri ekspertiza të karburantit, sipas protokolleve 190, 208, dhe 239 të përpiluara nga Instituti për Hulumtime në Bullgari, që kanë të bëjnë me cilësinë e tij, kurse aktgjykimin e bazon në dy ekspertiza (190 dhe 208), ndërkaq ekspertiza e tretë (239), e cila nuk ka rezultuar me ujë. Në kërkesë pretendohet se nuk janë marrë parasysh kontraditat e paraqitura nga Instituti për Hulumtime në Bullgari dhe aktgjykimet e kundërshtuara për këto fakte nuk përbëjnë arsye të qarta të cilat kanë pasur ndikim në marrjen e vendimit jo të ligjshëm dhe në dëm të të akuzuarit. Përveç kësaj mbrojtësi në kërkesë bën fjalë edhe për shkelje të tjera, por ë mënyrë të përgjithshme.

Mbrojtësi më tutje pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Dytë, në pjesën me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale mashtrim i blerësve, janë të kundërligjshme, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësinë penale të personit juridik, të parashikuar me dispozitën e nenit 106 të KPPK.

Kështu, mbasi sipas kërkesës, aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje të dispozitave ligjore të cekura më lart, mbrojtësi propozon që kërkesa në fjalë të pranohet dhe aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza për veprën penale mashtrim i blerësve nga neni 115 par.1 të LPK, ose aktgjykimet në këtë pjesë të prishen dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Prokurori Publik i Kosovës, me shkresën PPK.nr.37/2004 datë 10.08.2004, nuk është deklaruar përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Gjykata Supreme në seancën e mbajtur shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmoi thëniet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Pretendimet e mbrojtësit të të gjykuarit të theksuara në kërkesë kryesisht kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Pra, në fakt, kontestohet gjendja faktike e vërtetuar me aktgjykimet e kundërshtuara.

Me dispozitën e nenit 451 par.2 parashikohet se “kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin është vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë”. Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet që kanë të bëjnë me gjendjen faktike, në këtë fazë të procedurës, janë jolëndore.

Përkitazi me pretendimet tjera të theksuara në kërkesë, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPPK, sepse Gjykata e Shkallës së Parë, si dhe ajo e shkallës së dytë, i kanë vlerësuar provat në pajtim me dispozitën e nenit 387 të KPPPK, kurse për provat kontradiktore kanë vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 396 par.7 të KPPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose si të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore. Ato kanë bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara

gjatë shqyrtimit kryesor dhe lidhur me to kanë paraqitur konkludime të qarta. Si Gjykata e Shkallës së Parë, ashtu edhe ajo e shkallës së dytë të gjitha faktet vendimtare të çështjes i kanë vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë. Qasja e tyre ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, sepse kanë mbështetje në provat e administruara, kështu që asnjë fakt vendimtar në këtë çështje penalo-juridike nuk ka ngelur i dyshimtë dhe i pavërtetuar.

Gjykata Supreme pranon në tërësi qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Shkallës së Dytë, të shprehur në aktgjykimet e tyre, përkitazi me përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e të akuzuarit A. H. qëndrojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale mashtrim i blerësve nga neni 242 par.1 të KPPK.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 403 par.1 pika 12 dhe par.2 të KPPPK, as shkelje të ligjit penal-neni 14 të KPPK, lidhur me nenin 451 par.1 pika 1,2 dhe 3 të KPPPK. Pra, nuk është i bazuar pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji në dëm të të gjykuarit A. H..

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 456 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NE PRISHTINË

Pkl.nr.15/2004, datë 09.11.2004

Procesmbajtëse,
Drita Rexhaj

Kryetari i Gjykatës-kolegjit,
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 2(2) KPPK - kualifikimi juridik i veprës - neni 140(1) LPK - mashtrimi - aktgjykimi i ndryshuar - neni 152, 454, 456 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale të Pejës dhe të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës për shkelje të Nenin 2(2) të KPPK, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë dështuar të pranojnë dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar për shkak se pas hyrjes në fuqi të dispozitave të KPPK-së, gjykata është dashur të zbatojë ligjin më të favorshëm për të akuzuarin.

I pandehuri është akuzuar për mashtrim siç parashihet me nenin 140(1) të LPK-së, është shpallur fajtor, dhe është dënuar me me kusht.

Gjykata Supreme gjeti se Gjykata mundet, sipas vlerësimit të vet të pranojë, shqyrtojë apo refuzoi provat dhe gjeti se refuzimi i dëshmisë së dëshmitarit në gjyq nuk paraqet shkelje të të drejtave të mbrojtjes, siç parashihet me nenin 152 të KPPK-së.

Megjithatë, Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin në dëm të të Pandehurit për shkak se nuk është zbatuar ligji më i favorshëm për të pandehurin.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është pjesërisht e bazuar dhe ndryshoi aktgjykimin sipas nenit 2(2) të KPPK-së, në atë të veprës penale të mashtrimit siç parashihet me nenin 261(1) të KPPK-së që pasqyron një shqiptim më të favorshëm të dënimit se dënimi me të cilin i pandehuri ishte dënuar fillimisht.

Pkl.nr.16/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-Kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar Kolegji dhe gjyqtarët: Zait Xhemajli dhe mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit N. H. nga Fushë Pejë, komuna e Pejës, për shkak të veprës penale mashtrimi, parashikuar me nenin 140 par.1 të LPK, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së të gjykuarit, ngritur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Pejë, P.nr.155/2002 datë 03.07.2001, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap.nr.1/2003 datë 21.04.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Aprovohet pjesërisht kërkesa e të akuzuarit N. H. për mbrojtje të ligjshmërisë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap.nr.1/2003 datë 21.04.2004, vetëm përkitazi me cilësimin juridik, ashtu që Gjykata Supreme gjen se në veprimet e të akuzuarit përmbushen elementet e veprës penale mashtrimit parashikuar me nenin 261 par.1 të KPPK, ndërsa për pjesët tjera kërkesa refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Pejë, me aktgjykimin, P.nr.155/2002 datë 03.07.2001 e ka shpallur fajtor të akuzuarin N. H., për veprën penale mashtrimi, parashikuar me nenin 140 par.1 të LPK, dhe e ka gjykuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vjetësh, nuk kryen vepër penale të re.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin Ap.nr.1/2003 datë 21.04.2004, e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë, ndërsa ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit e refuzon si të pabazuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, i akuzuari N. H., ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal-neni 2 par.2 të KPPK., me propozim që Gjykata Supreme ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim Gjykatës së Shkallës së Parë.

I akuzuari konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë, P.nr.155/2002 datë 03.07.2001, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse nuk është aprovuar kërkesa për marrjen e provës-dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar E. Sh., H. B. e R. L., dhe në këtë mënyrë të gjykuarit i është shkelur e drejta në mbrojtje.

Ndërkaq, për sa i përket aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Dytë, i akuzuari pretendon se po ashtu është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me faktin se është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë i cili nuk ka aprovuar propozimin për dëgjimin e dëshmitarëve për të cilët u bë fjalë më lartë. Njëherit në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë i gjykuari konsideron se aktgjykimi i shkallës së dytë është përfshirë me shkelje të ligjit penal-neni 2 par.2 të KPPK, sepse dispozitat e Kodit Penal të Përkohshëm të cilat më vonë kanë hyrë në fuqi, janë më të favorshme për të akuzuarin, andaj Gjykata është dashur që ta bëjë ricalësimin e veprës penale me

dispozita të KPPK.

Prokurori Publik i Kosovës, konform nenit 454 par.2 të KPPPK, ka dhënë përgjegje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së të akuzuarit me shkresën, PPK.nr.38/2004 datë 06.08.2004, dhe ka propozuar që kërkesa e të akuzuarit të aprovohet dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ap.nr.1/2003 datë 24.04.2004 të ndryshohet vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale ashtu që vepra penale për të cilën është shpallur fajtor të cilësohet si vepër penale mashtrimi, parashikuar me nenin 261 par.1 të KPPK.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmtoi thëniet e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pjesërisht është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kërkesa e të akuzuarit për të ftuar dëshmitarët E. Sh., H. B. dhe R. L., nuk është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin Ap.nr.1/2003 datë 21.04.2004, e refuzon si të pabazuar pretendimin ankimor të të akuzuarit se me aktgjykimin e shkallës së parë është mohuar e drejta e mbrojtjes, me arsyetim se nga procesverbali i seancës kryesore rezulton se i akuzuari ka qenë i udhëzuar për të gjitha të drejtat e tij.

Me dispozitën e nenit 152 par.3 pika 1 të KPPK, është parashikuar se “Gjykata mund të refuzojë kërkesën për marrjen e provës: 1) Kur marrja e provës së tillë për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt, sepse çështja është e njohur në vija të përgjithshme”.

Me dispozitën e nenit 152 par.2 të KPPK, parashihet se “Gjykata sipas vlerësimit të vet, mund të pranojë dhe të marrë parasysh çdo provë të pranueshme që ajo mendon se është e rëndësishme për procedurën penale konkrete dhe ka autoritetin të vlerësojë lirish të gjitha provat e parashtruara me qëllim të përcaktimit të rëndësisë ose papranueshmërisë së tyre”.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, mos aprovimi i propozimit nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë që dëshmitarët e propozuar nga ana e të akuzuarit të dëgjohen në çështjen konkrete penale, nuk paraqet shkelje të së drejtës në mbrojtje siç pretendohet me kërkesë, me që është e drejtë e Gjykatës që për vërtetimin e gjandjes faktike të administrojë dhe të vlerësojë provat dhe atëherë kur konsideron se gjendja faktike është vërtetuar plotësisht, të refuzojë administrimin e atyre provave të cilat i konsideron sit ë parëndësishme. Bazur në këtë kjo Gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar plotësisht, të refuzojë administrimin e atyre provave të cilat i konsideron si të

parëndësishme. Bazur në këtë kjo Gjykatë konsideron se aktgjykimet e ankimuara nuk janë të përfshira me shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë e vendimeve në fjalë.

Me dispozitën e nenit 2 par.2 të KPPPK, është parashikuar se “në rast se Ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit përfundimtar, atëherë ndaj personit që gjendet nën hetime, i akuzuar apo që shpallet fajtor zbatohet ligji më i favorshëm.

Në rastin konkret, për të akuzuarin më i favorshëm është KPPK, sepse për këtë vepër penale është parashikuar dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vjet, prandaj në frymë të këtyre dispozitave, me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelë ligji penal në dëm të gjykuarit me që nuk është aplikuar ligji më i favorshëm për të akuzuarin. Për këtë arsye Gjykata Supreme duke e aplikuar nenin 2 par.2 të KPPK, aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ap.nr.1/2003 datë 21.04.2004, e ndryshoi ashtu që gjen se në veprimet e të akuzuarit sajohen të gjitha elementet e veprës penale mashtrim nga neni 261 par.1 të KPPK, dhe se i akuzuari për këtë vepër është fajtor.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Dytë përmban shkelje të ligjit penal të parashikuar nga neni 2 par.2 të KPPK.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 457 par.1 pika 1 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NE PRISHTINË
Pkl.nr.16/2004, datë 18.03.2005

Procesmbajtëse,
Drita Rexhaj

Kryetari i Gjykatës-kolegjit,
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 451(1) pika 3 KPPPK - ligjshmëria e aktvendimit gjyqësor - neni 203(3) dhe 203(1) LPK - falsifikimi i dokumentit - kërkesa e refuzuar - neni 445, 454, 456, 458 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe the Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për shkelje të nenit 451(1) pikës 3 të KPPPK-së, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata në shkallë të parë dhe të dytë ka nxjerrë konkluzione të cilat nuk ka mundur t'i nxjerrë në fazën e procedurës për përsëritjen e procedurës penale.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata në shkallë të parë ka bazuar aktvendimin e vet në dispozitat në fuqi të nenit 407(1) të LPPK-së, dhe se Gjykata në shkallë të dytë, në fazën e ankesës, kishte nxjerrë përfundim të drejtë kur kishte përcaktuar se kushtet ligjore për përsëritjen e lëndës nuk janë plotësuar, kryesisht për shkak se paraqitja e dëshmimeve shtesë nuk do të ishte esenciale për këtë çështje.

Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.

Pkl.nr.20/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- Kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar Kolegji dhe gjyqtarër: Mihtar Jasiqi dhe Zait Xhemajli, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionalë Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit Sh. H. nga Kastrioti, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit të parashikuar me nenin 203 par.3 lidhur me par.1 të LPK, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së të gjykuarit, ngritur kundër aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Ferizaj, KP.nr.56/2004 datë 12.07.2004, dhe aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KP.nr.285/2004 datë 03.08.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.12.2004, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të akuzuarit Sh. H. për mbrojtje të ligjshmërisë, ngritur kundër aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Ferizaj, KP.nr.56/2004, dhe aktvendimit të Gjykatës së Qarkut

në Prishtinë, KP.nr.285/2004 datë 03.08.2004.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Ferizaj, me aktvendimin KP.nr.56/2004 datë 12.07.2004, e hedh sit ë pabazuar kërkesën e të gjykuarit Sh. H. për përsëritjen e procedurës penale të përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ap.nr.120/2002 të datës 12.04.2004.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin KP.nr.285/2004 të datës 03.08.2004, e refuzon si të pabazë ankesën e të gjykuarit Sh. H. të paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Ferizaj KP.nr.56/2004 datë 12.07.2004.

Kundër këtyre aktvendimeve, i akuzuari Sh. H., ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale-neni 451 par.1 pika 3 të KPPPK.

I akuzuari konsideron se aktvendimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara nga neni 451 par.1 pika 3 të KPPPK, e cila qëndron në faktin se Gjykata në aktvendim bën vlerësime të cilat nuk mund t'i bëjë në këtë fazë të procedurës por vetëm në fazën e “shqyrtimit të konteaktoritetit ku ecurinë dhe mënyrën e veprimt e cakton par.2 e neni 445 dhe dispozitat punuese”. Nga kjo rrjedh se paraqitësi i kërkesës thirret vetëm në shkeljen e dispozitës së nenit 445 par.2 të KPPPK.

Ndërkaq, për sa i përket aktvendimit të shkallës së dytë, i akuzuari pretendon se ai është i përfshirë me të njejtat shkelje të dispozitave të procedurës penale, nga se me këtë aktvendim është vërtetuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë.

Kështu, i akuzuari konsideron se aktvendimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkeljet e dispozitave ligjore të cekura më lart, prandaj ka propozuar që kërkesa në fjalë të pranohet dhe aktvendimet e kundërshtuara të prishen, dhe lënda të kthehet në rigjykim, apo në bazë të nenit 458 lënda, t'i kthehet për vendosje një Gjykate tjetër kompetente të Shkallës së Parë.

Prokurori Publik i Kosovës, me përgjigjen ndaj kërkesës PPK.nr.40/2004 datë 23.09.2004, propozoi që kërkesa e të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës në kutpom të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmoi thëniet e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë aktvendimin e vet e ka bazuar në dispozitën e nenit 407 par.1 të LPP, sepse konsideron se faktet dhe provat e propozuara për përsëritjen e procedurës nuk janë të përshtatshme në bazë të të cilave do të lejohej përsëritja (rishikimi) i procedurës. Edhe Gjykata e Qarkut ka vlerësuar drejt kur e ka refuzuar ankesën si të pabazuar, duke gjetur se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përsëritjen e procedurës penale, për faktin se i gjykuari nuk ka prezentuar prova të reja të cilat do ta provonin ndonjë fakt relevant përkitazi me këtë çështje penalo-juridike e të cilat kishin me qenë të përshtatshme për lejimin e përsëritjes së procedurës penale.

Qëndron fakti se aktvendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë përmban disa vlerësime, të cilat sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk paraqesin shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin për të ndikuar në ligjshmërinë e marrjes së vendimit si nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë ashtu edhe nga Gjykata e Shkallës së Dytë.

Gjykata Supreme vlerëson se faktet dhe provat e propozuara nga ana e të akuzuarit, nuk janë të asaj natyre që do ta bënin të bazuar kërkesën, sepse të njejtat prova janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe në lidhje me provat tjera, prandaj edhe kjo Gjykatë konsideron se aktvendimet e ankimuar nuk janë të përfshira me shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë e vendimeve në fjalë.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 451 par.1 pika 3 të KPPPK.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 456 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pkl.nr.20/2004, datë 10.12.2004

Procesmbajtëse,
Drita Rexhaj

Kryetari i Gjykatës-kolegjit,
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 285(1), 285(2), 284(2) pika 1 KPPPK - bazat dhe kohëzgjatja e paraburgimit - neni 253(1) pika 1 në lidhje me nenin 23 KPPK - vjedhja e rëndë - kërkesa e refuzuar - neni 22(3), 306(5), 454(1), 455(1), 456 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komonale të Glllogovcit dhe the Gjykatës së Qarkut të Prishtinës për shkelje të nenit 285(1), 285(2) dhe 284(2) pika 1 e KPPPK-së, duke bërë pretendimin ankimor se paraburgimi i të pandehurit ishte zgjatur pa propozimin e prokurorit publik dhe pa informimin e të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës për propozimin për zgjatjen e paraburgimit dhe se kohëzgjatja e paraburgimit për atë periudhë kishte tejkaluar maksimumin e kohës së parashikuar me ligj.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në pajtim me dispozitat në fuqi dhe ka dhënë arsye të duhura ligjore dhe faktike. Gjykata Supreme ka vendosur se nëse i pandehuri është në paraburgim, dhe aktakuza nuk përmban propozim për lirimin e tij apo të saj, neni 306(5) i KPPPK-së lejon që kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë të veprojnë sipas detyrës zyrtare nga data e pranimit të aktgjykimit për të përcaktuar nëse zgjatja apo ndërprerja e paraburgimit kërkohet si e tillë.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.

Pkl.nr.22/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga Kryetari i gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji, dhe gjyqtarët: Zait Xhemajli dhe Miftar Jasiqi, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale të të akuzuarit B. S. dhe të miturit A. E., për veprën penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarit B. S., avokat Ibrahim Dobruna, për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të formës së prerë mbi vazhdimin e paraburgimit të Gjykatës Komonale Glllogovc, Kp.nr.11/2004 datë 21.9.2004 dhe të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Kp.nr.331/2004 datë 22.9.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8.10.2004, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të të akuzuarit B. S., për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të formës së prerë mbi vazhdimin e paraburgimit të Gjykatës Komunale Glllogvc, Kp.nr.11/2004 datë 21.9.2004, dhe të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Kp.nr.331/2004 datë 22.9.2004

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale Glllogvc me aktvendimin Kp.nr.11/2004 datë 21.9.2004, ua ka vazhduar paraburgimin të akuzuarit B. S. dhe të miturit A. E. në kuptim të nenit 306 par.5 dhe nenit 22 par.3 të KPPPK. Duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit, Gjykata e Qarkut Prishtinë, me aktvendimin Kp.nr.331/2004 datë 22.9.2004, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e përmendur.

Kundër këtyre aktvendimeve, mbrojtësi i të akuzuarit B. S. ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të KPPPK, të parashikuar me nenin 285 par.1 e 2 dhe nenit 284 par.2 pika 1 në dëm të të akuzuarit, duke propozuar që të aprovohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të priset aktvendimi i Gjykatës Komunale në Glllogvc Kp.nr.11/2004 datë 21.9.2004 dhe ai i Gjykatës së Qarkut Prishtinë Kp.nr.331/2004 datë 22.9.2004, ashtu që të akuzuarit t'i ndërpritet paraburgimi dhe të lihet për t'u mbrojtur në liri.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmoi thëniet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se vendimet, si i shkallës së parë, Kp.nr.11/2004 datë 21.9.2004, ashtu edhe ai i shkallës së dytë, Kp.nr.331/2004 datë 22.9.2004, janë marrë me shkelje të dispozitave të nenit 285 par.1 dhe 2 të KPPPK, ngase, sipas këtyre pretendimeve, me aktvendime të kundërshtuara paraburgimi është vazhduar pa propozimin e Prokurorit Publik dhe pa u informuar i pandehuri dhe mbrojtësi i tij përkitazi me propozimin për vazhdimin e paraburgimit. Gjithashtu mbrojtësi në kërkesën e tij pretendon se me aktvendimet e kundërshtuara është bërë edhe shkelja e dispozitës së nenit 284 par.2 pika 1 të KPPPK, që ka të bëjë me kohëzgjatjen e paraburgimit, meqë në rastin konkret të pandehurit paraburgimi është vazhduar më tepër se tre muaj.

Gjykata Supreme gjen se nuk qëndrojnë pretendimet e mësipërme ankimore e as që ka shkelje të tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kjo Gjykatë sipas detyrës zyrtare i vë re në, e të cilat kishin kushtëzuar prishjen e aktvendimeve të ankimuara.

Aktvendimet e ankimuara janë të qarta dhe konkrete; në to nuk ka kundërtënie; janë dhënë arsye të duhura juridike dhe faktike, të cilat i aprovon si të drejta dhe objektive kjo Gjykatë, sepse Gjykata e Shkallës së Parë ka vepruar në pajtim me dispozitat: e nenit 306 par.5 të KPPPK, sipas së cilës, "Kur i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe aktakuza nuk përmban propozimin për lirim të tij, kolegji prej tre gjyqtarësh mbrenda tri ditëve nga dita e pranimit të aktakuzës shikon sipas detyrës zyrtare nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për zgjatjen ose pushimin e paraburgimit. "Dhe nenit 284 par.2 pika 1 të KPPPK, sipas së cilës " Para ngritjes së aktakuzës paraburgimi nuk mund të zgjas më shumë se tre muaj, kur procedura zbatohet për vepër penale të denueshme me më pak se pesë vjet".

Siç rezultojnë nga shkresat e lëndës, në këtë çështje penale është ngritur aktakuza me datë 20.9.2004, kurse aktvendimet e kundërshtuara janë marrë më 21.9.2004 dhe 22.9.2004, domethënë par ngritjes së aktakuzës.

Nga kjo rezultojnë se nuk kemi shkelje të dispozitave të neneve 285 par.1 e 2 dhe 284 par.2 pika 1 të KPPPK. në dëm të të akuzuarit, për të cilat pretendon mbrojtja, andaj edhe për këto arsye kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë u refuzua si e pa bazuar.

Nga sa u tha më lart dhe në bazë të nenit 456 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pkl.22/2004, datë 8.10.2004

Procesmbajtëse,
Drita Rexhaj

Kryetar i gjykatës - kolegjit
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 123(2) dhe 125 KPPPK - dorëzimi dhe pranimi i kopjeve të vërtetuara të aktvendimit - neni 2(2) - kualifikimi juridik i veprës - neni 203(3) dhe 203(1) LPK - falsifikimi i dokumentit - kërkesa e refuzuar - neni 451, 454, 455 KPPPK dhe neni 41 LPJ]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut të Prizrenit për shkelje të nenit 123(2), 125 dhe 451(1) pikës 1 dhe pikës 3 të KPPPK-së, duke bërë pretendimin ankimor se i pandehuri kishte dështuar që të pranojë një kopje të vërtetuar të aktgjyqimit dhe se Gjykata e shkallës së dytë kishte ndryshuar aktgjykimin në pjesën që ka të bëjë me cilësimin juridik të veprës penale mirëpo ka bërë gabim në ndryshimin e aktgjyqimit sipas detyrës zyrtare në zbatimin e një dënimi më të rëndë.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatave Komunale u kishte dorëzuar kopjen e aktgjyqimit mirëpo kopja e aktgjyqimit ishte kthyer prapa.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së dytë nuk është i lidhur për nenin 2(2) të KPPK-së në shqiptimin e dënimit më të rëndë gjatë ndryshimit të aktgjyqimit. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së dytë gjatë caktimit të dënimit ka marrë parasysht të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e aktgjyqimit. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.

Pkl.nr.23/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarët: Zait Xhemajli dhe Fejzulah Hasani, anëtarë, me bashkpunëtorën profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale të gjykuarit P. K., nga fshati Hoqa e Qytetit, komuna e Prizrenit, për veprën penale falsifikim i dokumentit, të parashikuar nga neni 203 par.3 lidhur me par.1 të LPK, përkitazi me kërkesën e të gjykuarit, për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.488/2001 datë 4.10.2002 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ap.nr.60/2003 datë 6.8.2004, në seancën e Kolegjit të mbajtur më 18.3.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të gjykuarit P. K. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.488/2001 datë 4.10.2002 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ap.nr.60&2003 datë 6.8.2004.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Prizren, me aktgjykimin P.nr.488/2001 datë 4.10.2002, e ka shpallur fajtor të akuzuarin B. B., për veprën penale falsifikim i dokumentit, të parashikuar nga neni 203 par.3 lidhur me par.1 të LPK dhe e ka gjykuar me denim me kusht në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vjetësh, nuk kryen veprë penale të re.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin AP.nr.60/2003 datë 6.8.2004, me aprovimin e ankesës së Prokurorit Publik Komunal në Prizren dhe sipas detyrës zyrtare e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket cilësimit juridik, duke gjetur se në veprimet e të akuzuarit përmbushen elementet e veprës së njejtë penale, por nga dispozita e nenit 332 par.3 të KPPPK, dhe për këtë veprë penale i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) Euro, të cilën duhet të paguajë në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast të mos pagesës, ky dënim do të zëvendësohet me dënim me burg, duke ia llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) Euro për 1 (një) ditë burgu.

Kundër këtyre aktgjyqimeve, i akuzuari P. K., ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 123 par.2 dhe nenit 125 par.1 të LPP, dhe nenit 451 par.1 nën par.1 dhe 3 të KPPPK.

I akuzuari konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.488/2001 datë 4.10.2002, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 123 par.2 dhe nenit 125 par.1 të LPP, me pretendim se të gjykuarit nuk i është dorëzuar personalisht aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë.

Ndërkaq, për sa i përket aktgjyqimit të shkallës së dytë, i akuzuari pretendon se ai është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 451 par.1 nën par.1 dhe 3 të KPPPK, me pretendim se Gjykata e Shkallës së Dytë edhe pse e aplikoi ligjin më të favorshëm të akuzuarit i shqiptoi dënim më të rëndë.

Prokurori Publik i Kosovës, me shkresën PPK.nr.49/2004 datë

8.11.2004, shkresat e lëndës i kthen në kompetencë të mëtejme pa dhënë propozim.

Gjykata supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmoi thëniet e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Komunale në Prizren, aktgjykimin e shkallës së parë është përpjekur ti dorëzoj të akuzuarit P. K., në adresën e tij në Fshatin Hoqë e Qytetit, Komuna e Prizrenit me datë 05.11.2002, mirëpo fletë dërgesa për dorëzimin e tij është kthyer me arsyetim se nuk gjendet në shtëpi. Prandaj, kjo Gjykatë, aktgjykimin e shkallës së parë P.nr.488/2001 dt.04.10.2002 e ka publikuar në tabelën e shpalljeve prej datës 15.11.2002 deri më 30.11.2002.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme çmon se në rastin konkret nuk është bërë shkelja e dispozitave të neneve 123 par.2 dhe nenit 125 par.1 të LPP, (të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur është bërë tentimi i dorëzimit të aktgjykimin të shkallës së parë) sepse Gjykata e Shkallës së Parë ka vepruar konform dispozitës së nenit 123 par.3 të LPP, me të cilat parashihet se, kur për shkaqe të ndryshme të pandehurit nuk mundë ti dorëzohen vendimet nga dërgimi i të cilit rjedh afati për ankim, vendimi do të shpallet në tabelën e shpalljeve të Gjykatës dhe pasi të kalojnë tetë ditë nga dita e shpalljes, konsiderohet se është bërë dërgimi i plotfuqishëm.

Pretendimi ankimor se Gjykata e Shkallës së Dytë edhe pse e aplikon ligjin më të favorshëm të akuzuarit i shqipton një dënim më të rëndë, duke pretenduar në shkeljet e nenit 451 par.1 nën par.1 dhe 3 të KPPPK, nuk qëndron sepse sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, Gjykata është e obliguar ta bëjë ricilësimin konform dispozitës së nenit 2 par.2 të KPPPK, sipar të cilit, “në rast se Ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit përfundimtar, atëherë ndaj personit që gjendet nën hetime, i akuzuar apo që shpallet fajtor zbatohet ligji më i favorshëm”. Ndërsa në rastin konkret edhe pse Gjykata e Shkallës së Dytë me aprovimin e ankesës së Prokurorit Publik e sipas detyrës zyrtare (kryesisht) e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë duke aplikuar ligjin më të favorshëm nuk është e obliguar që ti shqiptoi dënim më të butë. Matja e dënimit nga ana e Gjykatës bëhet brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të parashikuar me ligj për ato vepra penale dhe duke i marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Shkallës së Dytë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rethanat që ndikojnë në

caktimin e lartësisë së dënimit, siç parasheh dispozita e nenit 41 të LPJ.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykat vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga 123 par.2 dhe 125 par.1 të LPP, dhe nenit 451 par.1 pika 3 të KPPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pkl.nr.23/2004, datë 18.03.2005

Procesmbajtëse,
Drita Rexhaj

Kryetari i Gjykatës kolegjit
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 281(1) pika 2(ii) dhe 281(2) KPPPK - bazat dhe kohëzgjatja e paraburgimit - neni 200 LPK - pjesëmarrja në grupin që shkakton dhunë - neni 157(1) LPK - veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme - neni 38 LPK - lëndimi i rëndë trupor - neni 115 KPPK nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik - neni 253(1) KPPK - vjedhja e rëndë - neni 145(2) LPK - shkaktimi i dëmtimit ndaj objektit të personit tjetër - kërkesa e refuzuar]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të gjyqarit të procedurës paraprake dhe aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, për shkelje të nenit 281(1) pikës 2(ii) dhe 281(2) të KPPPK-së. I pandehuri ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktvendimeve të sipërpërmendura me të cilin kërkon ndryshimin e vendimit për caktimin e paraburgimit dhe kohëzgjatjes së tij. Avokati mbrojtës tërheqi kërkesën. Prandaj, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën formalisht.

Pkl.nr.24/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarët: Miftar Jasiqi dhe Zait Xhemajli, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të pandehurit E. H. nga Prizreni, për veprat penale: pjesëmarrje në grupin që kryen veprën penale të parashikuar me nenin 200 të LPK, vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme të parashikuar me nenin 157 par.1 të LPK lëndim të rëndë trupor të parashikuar me nenin 38 të LPK, nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtarë, racor, fetar, fetar a etnik të parashikuar me nenin 115 të KPPK, vjedhje e rëndë të parashikuar me nenin 253 par.1 të KPPK dhe dëmtimi i një prone tjetër të parashikuar me nenin 145 par.2 të LPK, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit E. H., avokat Haki Lecaj nga Prizreni, paraqitur kundër aktvendimit të gjyqarit të procedurës paraprake për caktimin e paraburgimit Hep.nr.189/2004 të dt. 16.10.2004 dhe kolegjit penal të Gjykatës së Qarkut në Prizren Kp.nr.260/24 të datës 18.10.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.12.2004, mori këtë

A K T V E N D I M

Hidhet si e palejueshme kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit E. H., paraqitur kundër aktvendimit të gjyqarit të procedurës paraprake për caktimin e paraburgimit Hep.nr.189/2004 të

dt.16.10.2004 dhe atij të Kolegjit Penal të Gjykatës së Qarkut në Prizren Kp.nr.260/2004 të datës 18.10.2004,

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prizren, Gjykatësi procedurës paraprake, me aktvendimin Hep.nr.189/2004 datë 16.10.2004, ia ka caktuar paraburgimin të akuzuarit E. H. në kuptim të nenit 283 lidhur me nenin 281 par.1 pika 2 nën pika (ii) të KPPPK. Duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit, Gjykata e Qarkut Prizren, me aktvendimin Kp.nr.260/2004 datë 18.10.2004, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e përmendur.

Kundër këtyre aktvendimeve, mbrojtësi i të pandehurit, ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të KPPPK, të parashikuar me nenin 281 par.1 pika 2 nën pika (ii) dhe par.2 të KPPPK, në dëm të të pandehurit, duke propozuar që të aprovohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të ndryshohet aktvendimi i gjyqarit të procedurës paraprake për caktimin e paraburgimit Hep.nr.189/2004 të dt. 16.10.2004 dhe ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Qarkut në Prizren Kp.nr.260/2004 të datës 18.10.2004, ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet paraburgimi dhe të lihet për t'u mbrojtur në liri ose të anulohen dhe qështja të kthehet në rivendosje.

Prokurori Publik i Kosovës, me shkresën PPK.nr.50/2005 datë 8.11.2004, propozoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit avokat Haki Lecaj, me shkresën e datës 13.12.2004, e njofton Gjykatën se e tërheq kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Prandaj, Gjykata Supreme në kuptim të nenit 454 par.2 të KPPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pkl.nr.24.2004, datë 15.12.2004

Procesmbajtësi,
Drita Rexhaj

Kryetari i Gjykatës - kolegjit
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 387 dhe 396(1) KPPPK - marrja parasysh e fakteve gjatë pruarjes së aktgjykimit - neni 245 LPJ - prodhimi i paautorizuar dhe shitja e narkotikëve - kërkesa e refuzuar - neni 456 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatave Komunale dhe të Qarkut të Prizrenit për shkelje të nenit 387 dhe 396(1) të KPPPK-së, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykatat e të dyja instancave kanë dështuar të vlerësojnë drejtë dëshmitë në caktimin e aktgjykimeve.

Gjykata Supreme ka vendosur se nuk ka ndodhur kurrfarë shkelje e ligjit penal dhe atij të procedurës penale dhe se të dyja Gjykatat kishin zhvilluar një vlerësim dhe analizë të të gjitha dëshmive të cilat ishin administruar gjatë shqyrtimit kryesor dhe ka nxjerrë konkluzione të qarta përkitazi me dëshmitë.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.

Pkl.nr.25/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, kryetar kolegji dhe gjyqtarët: Zait Xhemajli dhe mr.sc.Fejzulla Hasani, anëtarë me bashkpunëtoren profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit J. J. nga Prizreni, për shkak të veprës penale prodhim i paautorizuar dhe vënia në qarkullim e narkotikëve, parashikuar me nenin 245 par.1 të LPJ, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të gjykuarit J. J., ngritur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren, Ap.nr.232/2003 datë 26.8.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2205 mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të akuzuarit J. J. për mbrojtje të ligjshmërisë, ngritur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren, P.nr.230/2003 datë 1.4.2004, dhe aktgjykimit të Gjykatës të Qarkut në Prizren, Ap.nr.232/2003 datë 26.8.2004.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Prizren ma aktgjykimin P.nr.230/2003 datë 1.4.2003, të akuzuarin J. J. e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale prodhim i paautorizuar dhe vënia në qarkullim e narkotikëve, parashikuar me nenin 245 par.1 të LPJ, për të cilën vepër e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, duke e llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej 28.1.2003 deri më 1.4.2003.

Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve, me aktgjykim Ap.nr.232/2003 datë 26.8.2004, e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin për dënimin, ashtu që në veprimet e të akuzuarit gjën se përmbushen elementet e veprës penale mundësin e përdorimit të narkotikëve, parashikuar me nenin 246 par.1 të LPJ, për të cilën i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj.

Kundër këtyre aktgjykimeve i akuzuari J. J., ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal.

Në kërkesën e të akuzuarit thuhet se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, dhe ai i Gjykatës Komunale në Prizren, përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe shkelje të ligjit penal. Lidhur me këto shkelje, i akuzuari në fakt bën fjalë për gjendjen faktike. Kështu, në kërkesë theksohet se lidhur me këtë çështje penalo-juridike si Gjykata e Shkallës së Parë ashtu edhe ajo e Shkallës së Dytë, me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se kam kryer veprën penale e cila më vëhet në barrë. Gjykatat aktgjykimet e veta i kanë mbështetë në deklaratën e të akuzuarit Gj. M. se kinse unë atij i kam shitur narkotikë, ndërsa tel unë nuk është gjetur asnjë lloj narkotiku.

Pra sipas kërkesës, aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje ligjore të cekura më lart, prandaj edhe propozon që kërkesa në fjalë të pranohet dhe aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuzat në mungesë të provave, ose aktgjykimet në këtë pjesë të prishen dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Prokurori Publik i Kosovës, me shkresën PPK.nr.51/2004 datë 8.11.2004, propozon që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i gjykuari J. J. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme në seancën e mbajtur shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmoi thëniet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar .

Pretendimet e të gjykuarit të theksuara në kërkesë kryesisht kanë të

bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Pra, në fakt kontestohet gjendja faktike e vërtetuar me aktgjykimet e kundërshtuara.

Me dispozitën e nenit 451 par.2 parashikohet se “kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë”. Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet që kanë të bëjnë me gjendjen faktike, në këtë fazë të procedurës, janë jolëndore.

Përkitazi me pretendimet tjera të theksuara në kërkesë, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, sepse Gjykata e Shkallës së Parë, si dhe ajo e Shkallës së Dytë, i kanë vlerësuar provat në pajtim me dispozitën e nenit 387 të KPPPK, kurse i për provat kontradiktore kanë vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 396 par.7 të KPPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose si të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore. Ato kanë bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor dhe lidhur me to kanë paraqitur konkludime të qarta.

Gjykata Supreme pranon në terësi qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Dytë, të shprehur në aktgjykimin e saj, përkitazi me përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe se në veprimet e të akuzuarit J. J., qëndrojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale mundësimi i përdorimit të narkotikëve, parashikuar me nenin 246 par.1 të LPJ.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, as shkelje të ligjit penal. Pra, nuk është i bazuar pretendimi i të akuzuarit se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji në dëm të gjykuarit J. J..

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 456 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Pkl.nr.25.2004, datë 18.3.2005

Procesmbajtësi,
Drita Rexhaj

Kryetari i Gjykatës - kolegjit
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 70(2) and 70(4) LPP - emërimi i avokatit mbrojtës nga Gjykata - neni 135(1) pika 1 dhe 135(2) LPK - vjedhje e rëndë në bashkëpjesëmarrje - aktgjykimi i prishur - urdhërimi i rigjykimit - neni 456 KPPPK]

Prokurori Publik paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë dhe the Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës për shkelje të nenit 70(2), 70(4), 364(1), 364(3) dhe 376(2) të LPK-së, duke bërë pretendimin ankimor se të dyja Gjykatat kanë shkelur parimin e mbrojtjes së obligueshme për shkak se i akuzuari nuk kishte avokat mbrojtës edhe pse vepra penale për të cilën i pandehuri është akuzuar është e dënueshme me 10 vjet burgim.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata në shkallë të parë ka shkelur procedurën penale duke mos caktuar avokatin mbrojtës për të akuzuarin si në fazën e ngritjes së aktakuzës ashtu edhe atë të gjykimin, siç parashihet me nenin 70 të LPP-së. Krahas kësaj, Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së dytë për vërtetimin e aktgjykimit është në kundërshtim me nenin 364 dhe 376 të LPP-së, për shkak se Gjykata është dashur të veprojë sipas detyrës zyrtare në caktimin e avokatit mbrojtës për të akuzuarin.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e prokurorit publik është e bazuar, ta prish aktvendimin dhe t'ia kthen lëndën Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pkl.nr.26/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-Kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa dhe gjyqtarët: mr.sc.Fejzulah Hasani dhe Zait Xhemajli, anëtarë, me bashkpunëtoren profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarit I. A., nga Vushtrria, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë të kryer në bashkveprim parashikuar me nenin 125 par.1 pika 1 dhe 2 të LPK-së, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit Publik të Kosovës, Ppk.nr.42/2004 datë 29.10.2004, ngritur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale Vushtrri, P.nr.35/2000 datë 22.12.2000 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ap.nr.42/2001 datë 20.05.2003, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.04.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Konstatohet se kërkesa e Prokurorit Publik të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë, është e bazuar dhe me aktgjykimin e formës së prerë të cilin e përbëjnë aktgjykimi i Gjykatës Komunale Vushtrri, P.nr.35/2000 datë 22.12.2000 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ap.nr.42/2001 datë 20.05.2003, është shkelur dispozita e nenit 70 par.2 e 4 të Ligjit të Procedurës Penale, kështë që aktgjykimet e lartpërmendura prishen, kurse çështja i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Vushtrri, me aktgjykimin P.nr.35/2000 datë 22.12.2000, e ka shpallur fajtor të akuzuarin I. A., për veprën penale të vjedhjes së rëndë të kryer në bashkëveprim parashikuar me nenin 135 par.1 pika 1 e 2 të LPK, ndërsa e ka gjykuar me kusht duke i caktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik, Komunal, Gjykata e Qarkut Mitrovicë me aktgjykimin Ap.nr.42/2001 datë 20.05.2003, e ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Komunale vetëm përkitazi me vendimin për denim, ashtu që Gjykata e Qarkut Mitrovicë të akuzuarin I. A. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve.

Kundër Këtyre aktgjyqimeve Prokurori Publik i Kosovës ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve të dispozitave të neneve 70 par.2 dhe 4, nenit 364 par.1 pika 3 dhe 376 par.2 të ligjit të Procedurës Penale (LPP). Prokurori Publik konsideron se Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur dispozitën e nenit 70 par.2 dhe 4 të LPP-së, ngase i akuzuari jo vetëm në momentin e dorëzimit të aktakuzës por as gjatë seancës kryesore nuk ka pasur mbrojtës ashtu siç obligojn dispozitat e nenit 70 par.4 të LPP-së, edhe pse për veprën penale për të cilën është akuzuar është paraparë dënimi me burgim deri në 10 (dhjetë) vjet, me ç'rast mbrojtja është e detyrueshme dhe kështu është shkelur edhe dispozita e nenit 364 par.1 pika 3 të LPP-së. Po ashtu, Prokurori Publik konsideron se edhe Gjykata e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së Prokurorit ka shkelur dispozitën e nenit 376 par.2 të LPP-së, sepse ka qenë e obliguar sipas detyrës detyrës zyrtare t'i vërej shkeljet esenciale të bëra nga Gjykata e Shkallës së Parë të cilën gjë nuk e ka bërë, por ka konstatuar se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Propozohet që aktgjykimet e lartcekura të prishen dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë gjeti se :

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari I. A., është akuzuar dhe shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes së rëndë parashikuar me nenin 135 par.1 pika 1 dhe 2 të LPK, për të cilin me ligj parashihet dënimi me burgim prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjet, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka caktuar mbrojtës për të akuzuarin jo vetëm pas ngritjes së aktakuzës pos as në shqyrtim kryesor. Gjykata e Shkallës së Dytë me aktgjykimin Ap.nr.42/2001 datë 20.05.2003, konstaton se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Duke pasur parasysh këtë gjendje, Gjykata Supreme vlerëson se si Gjykata e Shkallës së Parë ashtu edhe Gjykata e Shkallës së Dytë kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, konkretisht kanë shkelur dispozitën e nenit 70 par.2 e 4, nenit 364 par.1 pika 3 dhe nenit 376 par.1 pika 1 të LPP-së, sepse përkundër faktit se i akuzuari nuk ka dashur të angazhoj mbrojtës, në rastin konkret mbrojtja ka qenë e detyrueshme. Sipas dispozitës së nenit 70 par.2 të LPP-së, pas ngritjes së aktakuzës për veprën penale për të cilën sipas ligjit mund të shqiptohet dënim me 10 (dhjetë) vjet burgim ose dënim më i rëndë, i pandehuri duhet ta ketë mbrojtësin në kohën e dërgimit të aktakuzës. Sipas par.4 të këtij neni kur i pandehuri në rastet e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon vetë mbrojtës, Gjykata do t'ia caktoj mbrojtësin kryesisht për zhvillimin e mëtejme të procedurës deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë. Bazuar në këtë, konstatimi i Gjykatës së Shkallës së Dytë se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale është i paqëndrueshëm. Për këto arsye kërkesa e Prokurorit Publik të Kosovës është e bazuar prandaj aktgjykimet e kundërshtuara u prishen, kurse çështja i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Gjatë rigjyqimit, Gjykata e Shkallës së parë duhet t'i eliminojë shkeljet e lartcekura dhe pastaj të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 457 par.1 pika 2 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVË NE PRISHTINË
Pkl.nr.26/2004, datë 4.04.2005

Procesmbajtëse,

Kryetari i Gjykatës kolegjit,

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 403(1) pika 12 KPPPK - deklarimi i bazave që lidhen me provat materiale - neni 168(1) LPJ dhe 244(1) KPPK - prodhimi i parave të falsifikuara - kërkesa e refuzuar - neni 451, 454, 455, 456 KPPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të Gjykatës së Qarkut të Gjilan dhe Gjykatës Supreme të Kosovës për shkelje të nenit 403(1) pika 12 e KPPPK-së, duke bërë pretendimin ankimor se të dyja Gjykatat kanë dështuar të vlerësojnë drejtë dëshmitë dhe kanë bazuar aktgjyqimet e tyre në deklaratat e palës së dëmtuar.

Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës bazohej në pretendimin ankimor të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në shkallë të parë dhe të dytë, dhe përcaktoi se në bazë të nenit 451(2) të KPPPK-së, një kërkesë e tillë nuk mund paraqitet në këtë fazë të apelit.

Gjykata Supreme ka vendosur se të gjitha provat janë administruar në pajtim me kërkesat e dëshmitëve siç parashihen me nenin 387 dhe 396(7) të KPPPK-së.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e avokatit mbrojtës është e pabazë

Pkl.nr.27/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar, Avdi Dinaj, Shahdane Agani, Osman Tmava dhe Vjosa Nimani Zulfu, anëtarë, procesmbajtëse Drita Rexhaj, bashkëpunëtoresh profesionale, në lëndën penale të të gjykuarit K. B., nga Durrësi, Republika e Shqipërisë, me vendbanim në Gjilan, për veprën penale falsifikim i parave, parashikuar nga neni 244 par.1 të KPPK, përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të gjykuarit M. M., avokat nga Gjilani, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut Gjilan, P.nr.157/2003 datë 7 nëntor 2003 dhe aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.131/2004 datë 21 korrik 2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21 mars 2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të gjykuarit K. B., paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut Gjilan,

P.nr.157/2004 datë 7 nëntor 2003 dhe aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.131/2004 datë 21 korrik 2004.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Gjilan, me aktgjykimin P.nr.157/2003 datë 7 nëntor 2003, e ka shpallur fajtor të akuzuarin K. B. për veprën penale falsifikim i parave, parashikuar nga neni 168 par.1 të LPJ dhe e ka gjykuar me 8 (tetë) muaj burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 28.08.2003 gjer më 7.12.2003.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të gjykuarit, me aktgjykimin Ap.nr.131/2004 datë 21 korrik 2004, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që të gjykuarin K. B. e ka shpallur fajtor për veprën penale falsifikim i parave, parashikuar nga neni 244 par.1 të KPPPK, kurse në pjesët tjera aktgjykimin e goditur e ka vërtetuar, dhe ankesën e mbrojtësit të të gjykuarit e ka refuzuar si të pabazuar.

Kundër këtyre aktgjyqimeve mbrojtësi i të gjykuarit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal, por siç rrjedhë nga ankesa, edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në kërkesën e mbrojtësit të të gjykuarit thuhet se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Gjilan dhe ai i Gjykatës Supreme të Kosovës përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPPK dhe shkelje të ligjit penal. Lidhur me këto shkelje, mbrojtësi i të gjykuarit, në fakt bën fjalë për gjendjen faktike. Kështu, në kërkesë theksohet se lidhur me këtë çështje penalo-juridike si Gjykata e Shkallës së Parë ashtu edhe ajo e Shkallës së Dytë me asnjë provë nuk kanë vërtetuar që i gjykuari ta ketë kryer veprën penale që i ngarkohet. Gjykatat aktgjyqimet e veta i kanë mbështetur në deklaratat e të dëmtuarit.

Pra, sipas kërkesës, aktgjyqimet e kundërshtuara janë përfshirë nga shkeljet ligjore të cekura më lart, prandaj propozim që kërkesa në fjalë të pranohet dhe aktgjyqimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që i gjykuari të lirohet nga akuza ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Prokurori Publik i Kosovës me shkresën PPK.nr.52/2004 datë 8 nëntor 2004, shkresat e lëndës i ktheu në kompetencë dhe vendosje të mëtejme,

Pa dhënë ndonjë propozim konkret.

Gjykata Supreme në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 454 par.1 lidhur me nenin 455 par.1 të KPPPK, çmoi thëniet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Pretendimet e të gjykuarit, të theksuara në kërkesë, kryesisht kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Pra, në fakt kontestohet gjendja faktike e vërtetuar me aktgjykimet e kundërshtuara, kurse pretendimet e kërkesës se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal vetëm parafrazohen, duke mos u arsyetuar fare.

Me dispozitën e nenit 451 par.2 parashikohet që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin është vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Andaj kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet që kanë të bëjnë me gjendjen faktike, në këtë fazë të procedurës janë jashtlëndore.

Përkitazi me pretendimet e tjera të theksuara në kërkesë, kjo Gjykatë çmon se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal, sepse si Gjykata e Shkallës së Parë ashtu edhe ajo e Shkallës së Dytë i kanë vlerësuar provat e administruara në pajtim me dispozitën e nenit 387 të KPPK, kurse lidhur me provat kontradiktore kanë vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 396 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të provuara ose të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, lidhur me të cilat kanë nxjerrë përfundime të qarta dhe konkrete.

Gjykata Supreme pranon në terësi qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe asaj të Shkallës së Dytë të shprehur në aktgjykimet e veta përkitazi me përgjegjësinë penale të të gjykuarit K. B., në veprimet e të cilit qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale falsifikim i parasë, parashikuar nga neni 244 par.1 të KPPK.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerësonë se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal. Pra, nuk është i bazuar pretendimi se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji në dëm të të gjykuarit K. B..

Nga sa u tha më lart dhe në kuptim të nenit 256 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pkl.nr.27/2004, datë 21 mars 2005

Procesmbajtëse,
Drita Rexhaj

Kryetar i kolegjit,
Gjuran Dema

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë - neni 403 KPPK - shkelja e përgjithshme e procedurës penale - neni 245 dhe 22 LPJ - neni 229(2) PCK - blerja, posedimi dhe shpërndarja e paautorizuar dhe shitja e drogave të rrezikshme dhe substancave psikotropopike - kërkesa e refuzuar - neni 451, 454, 456 KPPK]

Avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës për shkelje të nenit 403 të KPPK-së.

Gjykata Supreme vlerëson se kërkesa mund të paraqitet për shkelje esenciale të procedurës penale nëse shkelja ndikon në ligjshmërinë e vendimit, siç parashihet me nenin 451 të KPPK-së.

Gjykata Supreme çmon se kjo kërkesë nuk është e lidhur me ligjshmërinë e aktgjykimit mirëpo vetëm përgjithëson disa nga rrethanat të cilat për nga përmbajtja ishin më të ngjashme me çështjet të cilat ishin objekt i shqyrtimit në shkallë të dytë.

Prandaj, Gjykata Supreme vendosi se kërkesa e avokatit mbrojtës është e pagabazë.

Pkl.nr.29/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - Kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Rexhep Haxhimusa, dhe gjyqtarët: Miftar Jasiqi dhe Zait Xhemajli, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale mr.sc.Flora Balidemaj, process mbajtëse, në lëndën penale kundër të gjykuarve Y. L. nga Kamenica dhe A. K. nga fshati Radavc, komuna e Pejës për veprën penale prodhim i paautorizuar dhe vënia në qarkullim e narkotikëve të kryer në bashkveprim të parashikuar me nenin 245 par.2 të LPJ, lidhur me nenin 22 të LPJ, duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të të gjykuarit A. K., avokat Sokol Mushkolaj për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, P.nr.268/2003 datë 31.7.2003 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr.504/2003 datë 27.04.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7.3.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pagabazuar kërkesa e mbrojtësit të të gjykuarit A. K. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut

Pejsë, P.nr.268/2003 datë 31.6.2003 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.504/2003 datë 27.4.2004.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Pejë, me aktgjykimin P.nr.268/2003 datë 31.7.2003, të akuzuarin A. K. e ka shpallur fajtor për veprën penale prodhim i paautorizuar dhe vënia në qarkullim e narkotikëve, të parashikuar me nenin 245 par.2 të LPJ-së, lidhur me nenin 22 të LPj-së, dhe e ka gjykuar me 8 (tetë) muaj burgim. Duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit, Gjykata Supreme me aktgjykimin Ap.nr.504/2003 datë 27.4.2004, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkitazi me cilësimin juridik, ashtu që të akuzuarin A. K. e shpallë fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rezikshëm dhe e substancave psikotrope të parashikuara me nenin 229 par.2 të KPPK-së.

Kundër këtyre aktgjyqimeve mbrojtësi i të gjykuarit A. K., av.Sokol Mushkolaj ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljësë ligjit penal dhe shkeljës esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 403 të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuaradhe të gjykuarin A. K. t'i shqiptojë një dënim më të butë, respektivisht dënim me gjobë.

Prokurori Publik i Kosovës, me parashitësën PPK.nr.65.04, datë 29.12.2004, konform dispozitës së nenit 454 par.2 të KPPK është përgjigjur se kërkesa mbrojtësit të ligjshmërisë, konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën e vetë, mbrojtësi i të gjykuarit, në mënyrë të përgjithshuar thekson se është bërë shkelja e rëndë e ligjit penal nga neni 404 lidhur me nenin 406 të KPPK-së, duke mos e precizuar se për cilat shkelje konkrete bëhet fjalë. Shton se Gjykata e Shkallës së Parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk i ka vlerësuar sa duhet rethanat lehtësuese që të gjykuarit i kanë shkuar në favor, me ç'rast ka mund t'i shqiptojë dënim vetëm me të holla që parashihet me atë rast me nenin në fjalë. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme këto pretendime nuk janë të bazuara për këto arsye:

Me dispozitën e nenit 451 të KPPK-së parashihet, se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtzakonshëm juridik, mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljës së ligjit penal; për shkak të shkeljeve esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 403 par.1 dhe në rat të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e

vendimit gjyqësorë.

Duke pasë parasyshë se në kërkesën e tij, mbrojtësi i të gjykuarit nuk e kundërshton aktgjykimin për këto baza ligjore për mbrojtje të ligjshmërisë, por vetëm përgjithëson disa rrethana që për nga përmbajtja më tepër i ngjajnë ankesës për shkak të vendimit për dënimin që ka qenë objekt shqyrtimi në shkallë të dytë apo një kërkesë për zbutjen e jashtzakonshme të dënimit që mund të paraqitet konform dispozitave përkatëse të KPPK, se sa kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që në rastin konkret është objekt shqyrtimi.

Gjykata Supreme vlerësoi se nuk ka kushte ligjore për pranimin e saj, prandaj në përputhje me dispozitën e nenit 456 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pkl.nr.29/2004, datë 07.03.2005

Procesmbajtëse,
Mr.sc.Flora Balidemaj

Kryetar i Gjykatës - kolegjit
Rexhep Haxhimusa